

Tiranë më, 05.03.2021

KALLËZIM PËR NDJEKJE PENALE

KALLËZUES: Can MURATAJ, i biri Azem dhe Tale, dtl 18.05.21969, lindur në Cerem, Tropojë, banues në Tiranë, me nr cel 068 488 1777.

KUNDËR: Eneid NAKUÇI, Prokuror pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

AKUZA: "Shpërdorim detyre", parashikuar nga Neni 248 të Kodit Penal .

BAZA LIGJORE: Neni 283 i Kodit të Procedures Penale.

P Ë R P A R A

PROKURORIA SË RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

PARASHTRIMI I RRETHANAVE TË FAKTIT.

I. AB INITIO.

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Tiranë ka rregjistruar procedimin penal nr.163 viti 2019, në tentativë, "Vjedhje me armë", "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit", "Grup i strukturuar Kriminal", "Kryerja e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal" dhe "Shpërdorimi i detyrës" të parashikuar nga nenet 79/b-22, 140, 278, 333/a, 334 dhe 248 të Kodit Penal, ardhur nga Prokuroria pranë Gjykates së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë.

Me datën 09.04.2019 rreth orës 15:20, është marrë informacion se në pisten e aeroportit "Nënë Tereza" Rinas-Tiranë, persona të panjohur dhe të maskuar nën përdorimin e armëve të zjarrit kanë vjedhur një sasi të konsiderueshme vlerash monetare që po transportoheshin në drejtim të Austrisë. Me marrjen e njoftimit është ngritur grupi hetimor i përberë nga ekspertë kriminalist të laboratorit të policisë shkencore dhe D.V.Policisë Tiranë si dhe nga oficerë të policies gjyqësore të Sektorin për Krime të Rënda pranë kësaj Drejtorie, nën drejtimin e Prokurorisë për Krime të Rënda.

Gjatë veprimeve hetimore të kryera është konstatuar se persona të paidentifikuar duke hapur me mjete prerëse (gersherë metalike) njerën nga portat hyrëse të emergjencës së rrethimit të sigurisë së aeroportit dhe pikerisht portën që ndodhet në anën perendimore të rrethimit të këtij aeroporti, në afersi të repartit të zjarrfikses të këtij aeroporti.

Pasi autoret kanë hapur me mjete prerëse (gersherë metalike) portën e emergjencës dhe kanë hyrë në ambjentet e brendshme të aeroportit me një automjet të tipit furgon me stemen e Volkswagen me mbishkrimin "Hetimi Tatimor" me targe AA 248 KE. Autoret të cilët kanë qenë pesë persona të maskuar kanë hyrë në ambjentet e brendshme të aeroportit dhe kanë shkuar tek vend qendrimi i avioneve dhe pikerisht të avioni i linjës ajrore "Austria Airlines" ku persona kanë zbritur nga automjeti dhe nën kercënimin e armëve të zjarrit, kanë arritur të vjedhin një sasi të konsiderueshme vlera monetare (e pa përcaktuar aktualisht).

Në këto momente pasi është marrë njoftim nga punonjësit e aeroportit janë ndjekur nga shërbimet e policisë të cilët kanë qënë me shërbim të planizuar jashtë ambjentëve të aeroportit dhe gjatë ndjekjes kanë shkëmbyer zjarr me autoret e grabitjes, ku si pasojë ka mbetur i vrarë njëri nga autoret e ngjarjes. Në vëndin e ngjarjes është gjetur një person i vdekur, me maskë, i identifikuar më pas me emrin Admir Murataj. Autorët e tjerë të ngjarjes kanë braktisur furgonin dhe janë larguar.

Në vëndin e ngjarjes, pranë trupit të mësipërm është gjetur një armë automatike model 56, kalibër 7.62 mm, me nr.1000929, me krëhër të vendosur dhe fishekë në fole, me siguresë të vendosur në pozicionin zjarr me breshëri. Pranë trupit është gjetur një granatë dore, në xhepat e jelekut, janë gjetur katër krëhër me municion të kalibrit 7.62 mm, dy granata tymuese, si dhe një armë zjarri pistoletë me numër në trup "2-00.101" si dhe tre krëhëra me fishekë model 54.

Në vëndin e ngjarjes janë gjetur dhe sekuestruar gjithashtu edhe gjashtë gëzhoja.

Në aktin e ekspertimit tekniko-balistik me nr.3896, datë 16.04.2019 të I.P.SH-së është arritur

ne përfundimin se, arma automatike model 56 dhe arma pistoletë model 54 janë në gjendje të rregullt teknike dhe në të dy tytat e armëve janë evidentuar mbetje të faktorëve plotësues të qitjes. Sasi prej 135 fishekë model 56 dhe 35 fishekë model 54, granata e dorës dhe dy granatat tymuese janë në gjendje të rregullt teknike. Gjashtë gëzhojat iu përkasin fishekëve luftarakë të modelit 56, kalibër 7.62 mm, dy nga këto gëzhoja janë qitur nga arma automatike me nr.1000929, e gjetur në vëndin e ngjarjes.

Në datën 10.04.2019 në fshatin Dritas, në lagjen "Parrucë", në një nga tynelet ish-ushtarake, është gjetur i djegur një automjeti tip furgon i markës "Mercedes-Benz". Brënda në këtë automjet janë gjetur dhe sekuestruar katër armë zjarri automatike në gjendje të djegur, vetëm me trupin metalik. Në aktin e ekspertimit tekniko balistik me nr.4234, datë 24.04.2019 të I.P.SH-së është arritur në përfundimin se, tre nga këto armë janë armë zjarri automatike model 30, një është armë zjarri automatike model 70. Armët e zjarrit janë të parregullta teknikisht.

Me vendimin të datës 02.06.2020, Prokuroria e Posacme ka bërë ndarjen e akteve të procedimit penal Nr. 136/2019.

Për tu theksuar është fakti që hetimet paraprake dhe akuza në emër të shtetit është përfaqësuar nga Prokurori Eneid Nakuci. Ndonëse kanë kaluar pothuajse dy vjet nga disa Memo të familjes Muarataj, dhe Neni 110 të K. Pr. Penale parashikon detyrimin të prokurorit të kthejë përgjigje brenda 15 ditëve asnjë përgjigje nuk është kthyer.

Gjithashtu ne cilesine e trashegimtarit te viktimes se vepres penale kerkojme te hidhet drite mbi keto pyetje :

- a. Cilet kane qene punonjesit e policise me gjeneralitet perkase antare te grupit te FNSH qe kane marre pjese ne shkembimin e zjarrit te pretenduar ne vjedhjen me arme te ndodhur ne Rinas ne date 9 Prill 2019 ?
- b. A jane respektuar dispozitat perkatese te ligjit nr 72/2014 « per perdorimin e armeve te zjarrit » dhe akteve te tjera nenligjore nga antaret e grupit te FNSH te policise se shtetit?

Gjithashtu, po ky prokuror në mënyrë tinzare dhe të kundraligjshme "mban në sirtar dosjen e sekuestrimit të pasurive".

Kështu me Vendimin Nr. 5, datë 25.03.2019 (ndodnëse të hetuar dhe pushuar procedimi Penal në vitin 2017 dhe 2018 nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë) të gjitha pasuritë janë vendosur nën sekastro preventive, kanë kaluar mbi dy vjet dhe nuk është përfunduar ky process gjyqësor.

IN HAEC VERBA, përfundimisht konkludojmë se ky shtetas ka konsumuar elementët e figurës të veprës penale të "Shpërdorim detyre", parashikuar nga Neni 248 dhe të Kodit Penal; për këtë qëllim kërkojmë regjistrimin e procedimit penal dhe marrjen e tij në përgjegjësi penale.

KËRKOJ:

Për sa më sipër, në bazë të Nenit 283 e vijues të Kodit Procedurës Penale kërkoj nga Prokuroria e Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimit te Organizuar, regjistrimin e procedimit penal marrjen në përgjegjësi penale të:

Eneid NAKUÇI, Prokuror pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për kryerjen e veprës penale të "Shpërdorim detyre", te parashikuar nga Neni 248 të Kodit Penal.

**Kallëzuesi
CAN MURATAJ**